



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORATI

Nr. 678/1 prot.

Elbasan, më 20.03.2020

URDHËR

Nr. 44 datë 20.03.2020

**"PËR NDËRPRERJEN E PROCESIT MËSIMOR NË UNIVERSITETIN E
ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" PËR PARANDALIMIN E
PËRHAPJES SË COVID-19"**

Në mbështetje të nenit 39 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 11 të Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", si dhe në zbatim të Urdhrit të Ministrit të MASR Nr. 97, datë 19.03.2020 "Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike e jo publike", për parandalimin e përhapjes së COVID-19",

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e procesit mësimor ne auditore në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për një periudhë 2 (dy) javore deri në datë 03 prill 2020.
2. Procesi mësimor të vazhdojë online, sipas udhëzimeve të secilit fakultet.
3. Ngarkohen të gjitha njësitë e Universitetit me zbatimin e këtij urdhri.

Ku urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Skender TOPI

